



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 539 prot.

Tiranë më, 19.03.2020

**UDHËZIM I PËRGJITHSHËM**

Nr. 03, datë 19.03.2020

**PËR**

**DISA MASA PROCEDURIALE NË PROKURORITË ME JURIDIKSION TË  
PËRGJITHSHËM NË FUNKSION TË PARANDALIMIT TË PËRHAPJES COVID-19**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronjat “b”, “f”, 42, 43, 45, 46 pikat 1, 2, 3 shkronja “ç”, 48 e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 59, 59/a, 63 në lidhje me nenet 47, 48, 49, 50 e vijues të Kodit Penal, neneve 228, 229, 230, 471, 476 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, vendimit datë 09.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Covid-19 dhe masave të përshkallëzuara për parandalimin e përhapjes së këtij coronavirusi;

**U D H Ë Z O J:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
**Qëllimi**

Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim marrjen e disa masave procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së coronavirusit COVID-19 (në vijim coronavirusi i ri) në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (në vijim IEVP).

Neni 2  
**Objekti**

Objekti i këtij udhëzimi të përgjithshëm është përcaktimi i masave procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019 dhe parandalimin e përhapjes së tij në IEVP.

## **KREU II MASAT PROCEDURIALE**

### **Neni 3**

#### **Masat proceduriale sipas fazave të procedimit penal**

Drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, vlerësojnë gjendjen, problematikën dhe nevojat e marrjes së masave proceduriale në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale në njësitë administrative që mbulon prokuroria që ai/ajo drejton, si dhe në zbatim të kompetencave të parashikuara në ligj<sup>1</sup> vendosin marrjen e masave proceduriale për bërjen kujdes sipas fazave të procedimit penal, siç mund të jenë:

1. Në fazën e hetimeve paraprake, vlerësimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurimit personal, në zbatim të kushteve dhe kriterëve ligjorë<sup>2</sup> që garantojnë sigurinë e nevojshme personale të personit të arrestuar në flagrancë apo ndaluar ose të personit nën hetim, dhe parandalimin e përhapjes së coronavirusit të ri.

2. Në fazën e diskutimeve përfundimtare në gjykimet e themelit vlerësimin, nëse plotësohen kushtet dhe kriteret ligjorë<sup>3</sup> për të kërkuar caktimin e dënimeve alternative të dënimit me burgim, dhe parandalimin e përhapjes së coronavirusit të ri.

3. Në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë, vlerësimin, nëse plotësohen kushtet dhe kriteret ligjorë<sup>4</sup> për të kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, dhe parandalimin e përhapjes së coronavirusit të ri;

nëse plotësohen kushtet dhe kriteret ligjorë<sup>5</sup> për vuajtjen e dënimit të mbetur me qëndrim në shtëpi, dhe parandalimin e përhapjes së coronavirusit të ri.

## **KREU III ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI**

### **Neni 4**

#### **Njohja, zbatimi dhe mbikëqyrja**

1. Me këtë udhëzim të përgjithshëm të njihen gjithë prokurorët në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve që ushtrojnë funksionet pranë strukturave hetimore përkatëse.

2. Me zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe struktura përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme<sup>6</sup>.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm<sup>7</sup>.

<sup>1</sup> Shih, nenin 42, 43, 45, 46, 48 e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

<sup>2</sup> Shih, nenet 228, 229 e 230 e vijues të K.Pr.Penale.

<sup>3</sup> Shih, nenet 58, 59, 59/a, 63 në lidhje me nenet 47, 48, 49, 50 e vijues të K.Penale.

<sup>4</sup> Shih, nenin 476 pika 1 shkronja “ç” në lidhje me nenet 470 e 471 të K.Pr.Penale.

<sup>5</sup> Shih, nenin 59/a të K.Penale dhe nenet 470, 471 e vijues të K.Pr.Penale.

<sup>6</sup> Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 6 pika 2 të ligjit nr.97/2016.

<sup>7</sup> Shih po aty nenet 46 pika 4.

Neni 5

**Hyrja në fuqi, afati i zbatimit dhe publikimi**

1. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe detyrimet e përcaktuara në të zbatohen deri në njoftimin zyrtar për përfundimin e masave për parandalimin e Covid-19.
- 2 Udhëzimi i përgjithshëm të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

**PROKUROR I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**

